



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit- Kancelarija Premijera-Office Of The Prime Minister
Sekretari i Përgjithshëm-Generalni Sekretar- Secretary General

Në mbështetje të nenit 59 paragrafi 5 i Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minalet, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-158, të shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës më datën 25 shtator 2010, për të identifikuar dhe intervistuar kandidatët për Bordin e Komisionit të pavarur për Miniera dhe Minerale, Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit më datën 05 shkurt 2015 shpall:

KONKURS

Për pozitat si vijon:

Katër (4) kandidatë për anëtarë të Bordit të Komisionit të pavarur për Miniera dhe Minerale.

KUALIFIKIMI DHE PËRSHTATSHMËRIA PROFESIONALE

Një kandidat për t'u zgjedhur anëtar i Bordit të Komisionit të pavarur për Miniera dhe Minerale, duhet të ketë kualifikime universitare dhe së paku pesë (5) vjet përvojë pune sipas nenit 59 pika 6.1- 6.8, dhe pika 7 e Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minalet, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-158.

Anëtari i Bordit të Komisionit të pavarur për Miniera dhe Minerale duhet të jetë shtetas i Republikës së Kosovës dhe të ketë kualifikimin superior në fushën e gjeologjisë, xehetarisë, inxhinierisë, ekonomisë së tregut, menaxhmentit apo në fushën juridike.

Së paku tre (3) anëtarë të Bordit të KPMM duhet të kenë përvojë të konsiderueshme në gjeologji ose xehetari.

KUSHTET

Kandidatët që konkurrojnë për anëtarë të Bordit të Komisionit të pavarur për Miniera dhe Minerale duhet të plotësojnë edhe këto kushte të përgjithshme, se:

- Nuk ka qenë i dënuar dhe nuk është nën hetime nga një gjykatë

- kompetente;
- Nuk ka shkelur kodin etik apo standardet e sjelljes profesionale, përveç nëse një dënim i tillë është ndryshuar nga një gjykatë ose organ tjetër i ankesave;
 - Nuk ka bërë përgënjeshtime materiale nën çfarëdo dëshmie nën betim;
 - Nuk ka qenë në post menaxhues të ndonjë kompanie që ka falimentuar gjatë dhjetë (10) vjetëve të fundit.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURRIMIT

Kandidatët për anëtarë të Bordit të Komisionit të pavarur për Miniera dhe Minerale duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- CV
- Letër motivimin
- Deklaratën nën betim (formular, i cili plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit)
- Dokumentacionet e parapara në kushtet e punësimit (dëshmitë e kualifikimit profesional, përvojës së punës)
- Certifikatën (dëshminë) që dëshmon se nuk është nën hetime
- Shtetas i Kosovës (kopje të pasaportës ose të letërnjoftimit).

Aplikuesi për konkurrim duhet të përgatisë deklaratën nën betim, në të cilën deklaron se ai/ajo i përmbush kushtet e kualifikimit, pavarësisë dhe të përshtatshmërisë profesionale. Çdo përgënjeshtim material, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca, ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipërpërmendur, do të rezultojë në diskualifikimin e menjëhershëm.

Dokumentacioni duhet të jetë në pliko (zarf) të mbyllur (të shkruhet emri dhe mbiemri si dhe emri i Komisionit të pavarur për Miniera dhe Minerale në të cilën konkurren kandidati) dhe të dorëzohen në Sekretariatit Koordinues të Qeverisë, kati 0, zyra nr. 2 Ndërtesa e Qeverisë.

Dokumentacioni i dorëzuar nuk kthehet. Origjinalet mund të kërkohen gjatë intervistës.

Për informata shtesë mund të njoftoheni përmes telefonit 038/ 200 14 400.

Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur.

Afati i konkursit është i hapur 30 ditë nga data e publikimit në shtypin ditor (prej datës 06 shkurt 2015 deri më datën 06 mars 2015).